



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-95  
Prishtinë, më 9 mars 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 9 MARS 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slobodan Petroviç dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmt Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Xheladin Hoxha, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga Presidenca, Lumnije Murati,  
Nga ZCN, Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe këto pika shtesë:

1. Shqyrtimi i çështjes së mbikëqyrjes së raportimeve dhe mandateve të agjencioneve të pavarura, dhe
2. Shqyrtimi i tri kërkesave për udhëtime zyrtare

Kryesia u pajtua me propozimet e Kryetarit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 mars 2010,
2. Organizimi i javës së Kuvendit të republikës së Kosovës

### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 mars 2010**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 mars 2010, u miratua pa vërejtje.

### **2. Organizimi i javës së Kuvendit të republikës së Kosovës**

**Kryetari** tha se Kuvendi i Republikës së Kosovës në muajin mars organizon “Javën e Kuvendit”, në kuadër të së cilës do të organizohen vizita në pesë (5) komuna të Kosovës: Gjakovë, Ferizaj, Besianë, Vushtri dhe Lipjan. “Java e Kuvendit” do të fillojë nga 15 marsi 2010 kurse do të përfundojë më 24 mars 2010, theksoi Kryetari.

### **Pikat shtesë:**

### **1. Shqyrtimi i çështjes së mbikëqyrjes së raportimeve dhe mandateve të agjencioneve të pavarura**

**Kryesia** pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

1. Ngarkohen anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti, të organizojnë takime me kryetarët e komisioneve parlamentare, me kryesuesit e agjencioneve të pavarura dhe me përfaqësuesin-anëtarin e Qeverisë së Kosovës lidhur

me Raportimet vjetore të agjencioneve të pavarura si dhe mandatin e anëtarëve të këtyre organeve.

2. Pas përfundimit të këtij aktiviteti, të informohet Kryesia e Kuvendit

## **2. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Parlamentin e Holandës**

**Kryesia** pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikoliç, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Suzana Novoberdaliu, Besa Gaxherri, Mufera Shinik, dhe Xhevdet Neziraj, në Holandë prej 16 mars deri më 19 mars 2010.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon Projekti Praktika Parlamentare Lindje-Perëndim, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohen nga buxheti i Kuvendit.

## **3. Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për realizimin e mëditjeve shtesë për anëtarin e Komisionit, Elheme Hetemi, me rastin e vizitës zyrtare në Gjermani dhe Francë nga 14-17 shkurt 2010**

**Kryesia** pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

### **V E N D I M**

Lejohet realizimi i mëditjeve për deputeten Elheme Hetemi, me rastin e vizitës zyrtare në Gjermani dhe Francë nga 14-17 shkurti 2010.

## **4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve: Nerxhivane Dauti, Enis Kervan dhe Mufera Shinik për lejimin e udhëtimit zyrtar në Republikën e Turqisë**

**Kryesia** pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

## V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit: Nerxhivane Dauti, Enis Kervan dhe Mufera Shinik si dhe përkthyeses nga administrata e Kuvendit Gulten Nobirda në Turqi prej 28 mars 2010 deri më 02 prill 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohen nga buxheti i Kuvendit.

\*\*\*

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**